

Njoftim për pozicion vakant

Në kuadër të Projektit fitues REEHUB (Regional Energy Efficiency Hub), pjese e Programit INTERREG IPA CBC Itali-Shqipëri-Mali i Zi, financuar nga Bashkimi Evropian, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë si Lead Partner ne projektin fitues REEHUB, fton kandidatët e interesuar për të aplikuar për pozicionin e punës si në vijim:

Menaxher Projekti në kuadër të Projektit fitues REEHUB pjesë e Programit të financuar nga BE, INTERREG IPA CBC Itali-Shqipëri-Mali i Zi, në Tiranë.

Menaxheri i Projektit do të koordinojë Komitetin e Menaxhimit të Projektit, i cili do të monitorojë progresin e projektit në termat financiar dhe kohorë. Menaxheri i projektit është përgjegjës për monitorimin e performancës dhe progresit të projektit kundrejt planit kohor dhe financiar, bën propozime për të amenduar plane nëse ndodhin të papritura gjatë projektit, ndërlihd komunikimin midis partnerit drejtues dhe partnerëve të projektit, dorëzon raportet financiare dhe progres raportet tek zyra e Programit, si edhe përcakton takimet dhe shpërndan komunikimet midis partnerëve.

Kërkesat dhe kualifikimet për Menaxherin e Projektit

- Diplomë universitare dhe pasuniversitare mundësisht në një nga vëndet e BE-së (minimumi 5 vjet studime në disiplinat e Inxhinierisë së Ndërtimit, Arkitekturës dhe Inxhinierisë Elektrike, master ose PhD në lidhje me Projektimet e Qëndrueshme dhe Efiçencën e Energjisë);
- Të paktën 3 vjet eksperiencë profesionale në 5 vitet e fundit, në fushën e shkrimit, menaxhimit dhe koordinimit të projekteve të financuara nga BE ose donatorë të tjerë;
- Rrjedhshmëri në gjuhën e shkruar dhe të folur italiane dhe angleze;
- Njohuri shumë të mira kompjuterike (Excel, Word processing, përgatitja e prezantimeve);

Procedura e aplikimit

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë dokumentat e aplikimit si më poshtë:

- Curriculum vitae (CV) në formatin *European*;
- Fotokopje të diplomave universitare, master, PhD;
- Të provojnë njohuritë e gjuhës angleze (nëse diploma universitare është marrë në një program studimi në gjuhën angleze ose italiane, nuk është e nevojshme dëshmia e gjuhës);
- Dokumente të tjera mbështetëse (çertifikata të fituara nga trajnime, pjesëmarrje në konferenca, botime, letra reference, etj).

*Kandidatët e interesuar duhet t'i dorëzojnë dokumentet e aplikimit deri më datë **27/04/2018**, ora 10.00, në adresën elektronike si në vijim: entela.cipa@infrastruktura.gov.al, me subjekt: **Aplikim për pozicionin Menaxher Projekti , Projekti REEHUB, INTERREG IPA CBC Itali-Shqipëri-Mali i Zi***

Koordinator Projekti në kuadër të Projektit fitues REEHUB pjesë e Programit të financuar nga BE, INTERREG IPA CBC Itali-Shqipëri-Mali i Zi, në Tiranë.

Koordinatori i Projektit do të do të kontrolloje, monitorojë dhe do të mbikëqyr projektin si dhe do të jetë përgjegjës për çdo informacionin lidhur me projektin.

Kërkesat dhe kualifikimet për Koordinator Komunikimi

- Diplomë universitare (minimumi 5 vjet studime në disiplina të fushave ekonomike dhe financiare);
- Të paktën 3 vjet eksperiencë profesionale, në fushën e shkrimit, menaxhimit dhe koordinimit;
- Rrjedhshmëri në gjuhën e shkruar dhe të folur italiane dhe angleze;
- Njohuri shumë të mira kompjuterike (Excel, Word processing, përgatitja e prezantimeve);

Procedura e aplikimit

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë dokumentat e aplikimit si më poshtë:

- Curriculum vitae (CV) në formatin *European*;
- Fotokopje të diplomave universitare, master, PhD;
- Fotokopje të Diplomave/Certifikatave që provojnë njohuritë e gjuhës angleze (nëse diploma universitare është marrë në një program studimi në gjuhën angleze ose italiane, nuk është e nevojshme dëshmia e gjuhës);
- Dokumente të tjera mbështetëse (çertifikata të fituara nga trajnime, pjesëmarrje në konferenca, botime, letra reference, etj).

*Kandidatët e interesuar duhet t'i dorëzojnë dokumentet e aplikimit deri më datë **27/04/2018**, ora 10.00, në adresën elektronike si në vijim: entela.cipa@infrastruktura.gov.al: **Aplikim për pozicionin Koordinator Projekti , Projekti REEHUB, INTERREG IPA CBC Itali-Shqipëri-Mali i Zi***

Jurist në kuadër të Projektit fitues REEHUB pjesë e Programit të financuar nga BE, INTERREG IPA CBC Itali-Shqipëri-Mali i Zi, në Tiranë.

Juristi i projektit do të ofroje konsulenca ligjore lidhur me projektin, do të hartojë dhe vlerësojë dokumentacionet, lidhjen e kontratave të ndryshme në lidhje me projektin si dhe do të jetë përgjegjës për çdo veprimtari ligjore lidhur me projektin.

Kërkesat dhe kualifikimet për Jurist

- Diplomë universitare dhe pasuniversitare (minimumi 5 vjet studime në drejtësi, masteri në drejtësi të biznesit evropian përben avantazh);
- Të paktën 3 vjet eksperiencë profesionale, në fushën e prokurimeve, konsulencave juridike si dhe në fushën e projekteve;
- Rrjedhshmëri në gjuhën e shkruar dhe të folur italiane dhe angleze

Procedura e aplikimit

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë dokumentat e aplikimit si më poshtë:

- Curriculum vitae (CV) në formatin *European* ;
- Fotokopje të diplomave universitare, master, PhD;
- Të provojnë njohuritë e gjuhës angleze (nëse diploma universitare është marrë në një program studimi në gjuhën angleze ose italiane, nuk është e nevojshme dëshmia e gjuhës);
- Dokumente të tjera mbështetëse (çertifikata të fituara nga trajnime, pjesëmarrje në konferenca, botime, letra reference, etj).

Kandidatët e interesuar duhet t'i dorëzojnë dokumentet e aplikimit deri më datë **27/04/2018**, ora 10.00, në adresën elektronike si në vijim: entela.cipa@infrastruktura.gov.al, me subjekt: **Aplikim për pozicionin Jurist i Projektit, Projekti REEHUB, INTERREG IPA CBC Itali-Shqipëri-Mali i Zi**

Ekspert finance në kuadër të Projektit fitues REEHUB pjesë e Programit të financuar nga BE, INTERREG IPA CBC Itali-Shqipëri-Mali i Zi, në Tiranë.

Eksperti financiar do të kontrollojë kostot duke monitoruar statusin e projektit për të azhurnuar kostot e projektit dhe menaxhimin e ndryshimeve në bazën e kostos, si dhe do të jetë përgjegjës për çdo aktivitet tjetër ekonomik-financiar që lidhet me projektin.

Kërkesat dhe kualifikimet për ekspert financiar:

- Diplomë universitare (minimumi 5 vjet studime në fushën ekonomike-financiare)
- Të paktën 3 vjet eksperiencë profesionale, në fushën e menaxhimit, administrimit, marketingut si dhe në fushën e konsulences financiare;
- Rrjedhshmëri në gjuhën e shkruar dhe të folur italiane dhe angleze;

Procedura e aplikimit:

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë dokumentat e aplikimit si më poshtë:

- Curriculum vitae (CV) në formatin *European* ;
- Fotokopje të diplomave universitare, master, PhD;
- Fotokopje të Diplomave/Certifikatave që provojnë njohuritë e gjuhës angleze (nëse diploma universitare është marrë në një program studimi në gjuhën angleze ose italiane, nuk është e nevojshme dëshmia e gjuhës);
- Dokumente të tjera mbështetëse (çertifikata të fituara nga trajnime, pjesëmarrje në konferenca, botime, letra reference, etj).

Kandidatët e interesuar duhet t'i dorëzojnë dokumentet e aplikimit deri më datë **27/04/2018**, ora 10.00, në adresën elektronike si në vijim: *entela.cipa@infrastruktura.gov.al*, me subjekt :

Aplikim për pozicionin Financier i Projektit, Projekti REEHUB, INTERREG IPA CBC Itali-Shqipëri-Mali i Zi